

VENDIM
Nr. 84/2019

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR
KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË KRYERA NGA ANA E
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË KUADËR TË
USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË TIJ LIDHUR ME ZHVILLIMIN E
ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të neneve 7 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, 5, pika 2, dhe 8, pika 1, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të neneve 55 dhe 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, bazuar në kërkesën e 55 deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

II. Ky hetim ka për qëllim njohjen, si dhe verifikimin e mënyrës së ushtrimit të kompetencave nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, në përputhje me parimet kushtetuese, si parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë konkrete institucionale.

III. Objekt i punës së komisionit hetimor janë:

a) verifikimi i procedurave të ndjekura nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë gjatë ushtrimit të kompetencave lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore;

b) hartimi i akteve, si dhe efektet e tyre juridike në raport me kompetencat e Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

c) pasojat e këtyre akteve në raport me institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë, si Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo gjykatat;

ç) sjellja dhe qëndrime të caktuara të Presidentit të Republikës në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

IV. Komisioni Hetimor parlamentar përbëhet nga 9 deputetë, si më poshtë:

- | | |
|----------------------|-----------------|
| 1. Ulsi Manja | kryetar |
| 2. Alban Zeneli | zëvendëskryetar |
| 3. Vasilika Hysi | anëtare |
| 4. Klotilda Bushka | anëtare |
| 5. Bashkim Fino | anëtar |
| 6. Alket Hyseni | anëtar |
| 7. Adriatik Alimadhi | anëtar |
| 8. Halit Valteri | anëtar |
| 9. Krenar Rryçi | anëtar |

Anëtarë zëvendësues caktohen:

- | | |
|------------------|----------------------|
| 1. Adnor Shameti | Grupi parlamentar PS |
| 2. Spartak Braho | Grupi parlamentar PS |

3. Arlind Çaçani Grupi “Demokrat”

4. Zef Shtjefni Grupi “Partitë e Djathta”

V. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në mënyrë të arsyetuar nëse ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 8.7.2019.